# DËSHMI ARKIVI

**A-448153**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Toshkovski: Rënie e vrasjeve dhe e krimeve të tjera në krahasim me vitin e kaluar |
| ADRESA | `https://albeu.com/maqedoni/toshkovski-renie-e-vrasjeve-dhe-e-krimeve-te-tjera-ne-krahasim-me-vitin-e-kaluar/1013853/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 08:43:17 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 08:38:09 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `3f1509922e9ac80a25ae92c6f76da15fa770877f914263b279a723a8b1dda907` |
| TEKSTI | `74dfd0f33c56caac5eaf0a11abbedeb0fccc3771cf085136281ac62e27be1938` |
| PAMJA | `b08d39974ac362ea7bd40ff589f7b437d63dcb32689ff6f632a05381d958577a` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ab5337c8553902c6ebe021fe5f21a73e965d3caa79230cdc40063f1cad45ed82` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `479381fa2a49a22c779ba6938b50ec298f3d05b6f6a0c36ab6b39ef80d1b34ab` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ab5337c8553902c6ebe021fe5f21a73e965d3caa79230cdc40063f1cad45ed82`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Toshkovski: Rënie e vrasjeve dhe e krimeve të tjera në krahasim me vitin e kaluar



Gjatë paraqitjes së tij në RTMV, ministri i Punëve të Brendshme, Pançe Toshkovski, trajtoi gjendjen aktuale të sigurisë, hetimin për vrasjen në Çair dhe ecurinë e kriminalitetit në tetë muajt e parë të këtij viti.

Për vrasjen në Çair, ai njoftoi se hetimi po vazhdon ende dhe se po qartësohen rrethanat që lidhen me njërin nga dy të dyshuarit, përfshirë edhe arsyen përse personi ndodhej në arrati në kohën e kryerjes së krimit.

Toshkovski u shpreh se në këtë fazë nuk mund të publikojë hollësi të mëtejshme për hetimet dhe pret që të dyshuarit të privohen nga liria në një të ardhme të afërt. Ai kujtoi se në rastet e mëparshme të krimeve të rënda, personat e dyshuar janë siguruar dhe ndaj tyre janë marrë masat e duhura.

Duke iu përgjigjur pyetjes nëse qytetarët janë të sigurt, ministri theksoi se siguria duhet të vlerësohet mbështetur në të dhënat dhe krahasimet konkrete, e jo vetëm përmes ngjarjeve të veçanta.

Toshkovski e cilësoi si legjitime pyetjen për sigurinë e qytetarëve dhe tha se mund të përgjigjet lirisht "po", por shtoi se bëhet fjalë për një çështje komplekse. Sipas tij, kjo nuk mund të interpretohet jashtë numrave, statistikave dhe realitetit.

Nga të dhënat që ai prezantoi, në periudhën janar–gusht 2026 u regjistrua rënie në disa kategori të krimeve të rënda krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Numri i vrasjeve zbriti nga 19 në 12, ose rreth 37 për qind. Numri i kryerësve ra nga 26 në 13, ndërsa numri i viktimave nga 20 në 12, që përbën një ulje prej rreth 40 për qind.

Një rënie veçanërisht e theksuar, afërsisht 65 për qind, u shënua te vrasjet e mbetura në tentativë. Grabitjet u ulën me rreth 40 për qind, kurse vjedhjet e rënduara me afërsisht 30 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025.

të fundit/


Toshkovski: Rënie e vrasjeve dhe e krimeve të tjera në krahasim …


Të gjithë me sytë nga Haga, seanca për shpalljen e vendimit p…


Gazmend Hoxha: Policia ka ndërmarrë masat e nevojshme p…


Turmë qytetarësh në sheshin "Skënderbeu" në pritje të vendimit n…


Arteta lartëson Merinon: Mesfushori spanjoll, ndër më…


Shqipëria mbetet pa Grudën, Klopp e thërret te Gjermania për duel…


Bekim Sali: Liria e një populli nuk mund të jetë objekt i asnjë gjykimi,…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Ministri theksoi se mund të vlerësojë lirisht se ka rënie të numrit të këtyre krimeve të dhunshme. Te grabitjet, theksoi ai, rënia është rreth 40 për qind, ndërsa te vjedhjet e rënduara rreth 30 për qind.

Toshkovski vlerësoi se këta tregues dëshmojnë përmirësim të gjendjes së sigurisë në fushën e krimit të dhunshëm dhe atij kundër pronës, por shtoi se ka edhe kategori krimesh në të cilat është regjistruar rritje.

Shtuar më 16.09.2026 10:38

Tags: Mpb maqedoni , Pançe toshkovski



LSDM kërkon nga Prokuroria hetim për financimin e festës së…


Bekim Sali: Liria e një populli nuk mund të jetë objekt i asnjë gjykimi, UÇ…


QMK raporton: Asnjë vatër zjarri aktive, 11 prej tyre janë shuar plotësisht


Industria e Maqedonisë së Veriut rrit qarkullimin vjetor me 2.7%


Në Gjykatën Penale në Shkup dëshmojnë për rastin ndaj gjykatësit Gjo…


Gjorgievski: Punimet për Transportin e Shpejtë Autobusësh pritet të nisin…


Sali: Zgjerimi i BE-së lidhet drejtpërdrejt me sigurinë, kërkohen reforma të…


Andonovski: Qendra Kombëtare e të Dhënave do të ngrihet afër parqev…

albeu © 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko... Kërko

**Kryesore**
Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

**Kategori**
Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

**Linqet**
Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

**Tags**
Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

**Moti**
Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com |

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.